C.nr.942/19

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm,Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu**,**në çështjen kontestuese të paditësit G.S ,.....,kundër të padituës Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj ,të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson S.V ,përfaqësues juridik,baza juridike :shpërblim jubilar,pagesa përcjellse në pension me datë 25.10.2019 mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit G.S,dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj,që paditësit G.S të ia paguaj shumat siq vijon:në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 539.94 euro,në emër të pagesës përcjellse në pension ,shumën prej 358.16 euro,të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi G.S ,me .... , ka parashtruar me padi në këtë Gjykatë, kundër të padituës Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesën e pagesës përcjellse në pension.

Nga thënjet e paditësit në padi rezulton se i njejti padin e bazon në faktin se ka qenë në mardhënje pune te e paditura si punëdhënës i fundit i tij ,në vendin e punës mësimdhënës deri me datë 10.05.2019,ku sipas fuqisë ligjore i është ndërprerë mardhënja e punës për shkak të pensionimit ,mirëpo e paditura paditësit nuk ia ka paguar pagat që i kërkon me kërkesëpadi edhe pse të njejtat paditësit i takojnë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës.

Paditësi gjatë seancës ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

E paditura Komuna e Ferizajit-Drejtoria e Arsimit në Ferizaj në lidhje me qështjen kontestuese përmes të autorizuarit të sajë S.V ka deklaruar: Paditësi ka ushtruar padi, kundër të padituës Komunës së Ferizajit, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, kompensimin e shpërblimit të pagave jubilare dhe përcjellse në shumën e përgjithshme prej 2156.16 euro . E paditura, Komuna Ferizaj e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e

paditësit si të pa bazuar. Konform nenit 35 pika 8.1,8.2,8.3,8.4,8.5 dhe 8.6 është paraparë tekstualisht mënyra e realizimit të shpërblimit jubilar dhe afati i realizimit të kësaj të drejte, duke e specifikuar se për çdo 10 vjet shpërblim për pagën bazë.Kurse me pikën 10 të nenit 35 është përcaktuar përfitimi i pagës përcjellse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.Sipas listave të pagave konstatohet se paditësi për muajin mars 2019 ka realizuar pagë prej 539.04 euro ,për mujin prill 2019 ka realizuar pagë 539.94 euro dhe për mujin maj 2019 të vitit 2019 ka realizuar pagë në shumë prej 181.37 euro,shuma totale për tre muajt e fundit 1260.35 euro euro.Njëkohësishtë ka realizuar edhe të drejtën e pagave përcjellse në shumën prej 1258.96 euro. Njëkohësisht edhe shuma e paraqitur në kërkesën e padisë për kompenzim të tri pagave jubilare pas pensionimit nuk ka përputhshmëri të të dhënave faktike ,sepse sipas Drejtorsë së Arsimit në Ferizaj.Me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit mbi arsimin parauniversitar ,Ligjit të Arsimit të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Kontratës së Punës për mësimdhënës nuk është paraparë kompensimi i pagave jubilare dhe përcjellëse.Njëkohësisht drejtoria e arsimit si punëdhënës nuk është nënshkruese e Kontratëse kolektive, gjë qe nuk mund edhe te obligohet derisa derisa nuk ka marrë obligime kontraktuale. Nga të gjitha provat e afruara dhe theksimeve te lartëshenuara i propozojmë gjykatës të merr këtë aktgjykim: te refuzohet, kerkesë padia e paditësit,G.S ,si e pa bazuar.

Gjykata provat e administruara i ka vlerërsuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Me leximin e vendimit .nr.07nr./346,i datës 02.05.2019 ,gjykata ka vërtetuar se paditësi G.S,ka qenë në mardhënje pune te e paditura në vendin e punës mësimdhënës ,në ..... dhe se i është ndërperë mardhënja e punës sipas fuqisë ligjore ,për shkak të arritjes së moshës së pensionimit 65 vjeqare,me datë 10.05.2019,kurse me të njejtin vendim ishte paraparë që paditësi në emër të pagesës përcjellse në pension të realizoi shumën prej 1258.96 euro.

Me leximin e shkresës së lëshuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ,me numër.....,e muajit maj 2019 ,gjykata ka vërtetuar se paditësit në emër të pagesës përcjellse në pension i është paguar shuma prej 1098.61 euro neto ,me bazën e llogaritjes bruto 1258.96 euro.

Me leximin e listës së pagës për muajin mars 2019,gjykata ka vërtetuar se paditësi për muajin mars 2019 ka realizuar pag mujore neto 539.04 euro.

Me leximin e listës së pagës për muajin prill 2019 ,gjykata ka vërtetuar se paditësi për muajin prill 2019 ka realizuar pag mujore neto 539.94 euro.

Me leximin e listës së pagës për muajin maj 2019,gjykata ka vërtetuar se paditësi për mujin maj 2019 ka realizuar pjesë të pagës mujore neto për 10 ditë pune ,në vlerë prej 181.37 euro.

Nga ajo që u theksua më sipër rezulton se tri paga mujore të paditësit neto nga 539.04 euro bëjnë 1617.12 euro ,kurse ne emër të pagave për përcjellje ju kanë paguar bruto 1258.96 euro mbetja është 358.16 euro e papaguar nga e paditura në emër të pagave për përcjellje në pension.

Nga listat e sipër përmendur e pagave vërtetohet se paditësi ka përvojë pune 38 vite.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues ekzistimi i faktit se e paditura paditësit nuk ia ka paguar shumat e mjeteve monetare që paditësi i kërkon me kërkesëpadi.

Me nenin 35 paragrafi 8,pika 8.3 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë,të datës 18.04.2017,është paraparë se punëtorët në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit , për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë , kurse me paragrafin 8.5 te nenit 35 te sipër përmendur është paraparë se shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse.

Kurse për rastin konkret llogaritja e shpërblimit jubilar është bërë në bazë të pagës bazë të paditësit që është 539.94 euro.

Me nenin 35 paragrafi 9, të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë,të datës 18.04.2017 është paraparë se punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit .Pagat përcjellse paguhen nga punëdhënësi fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionimit.

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e sipër përmendura të Kontratës Kolektive Sektoriale, si dhe gjendjes faktike të shpjeguar më lartë ,ka ncjerrur përfundim se është e bazuar kërkespadia e paditësit dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse nga provat e administruara dhe faktet jo kontestuese u vertetuar fakti se paditësi G.S , ka qenë në mardhënje pune te e paditura me përvojë pune 38 vite, ,mirëpo e paditura nuk ia ka paguar paditësit shumën e mjeteve monetare si ne piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe pse ka pasur obligim t'ua paguaj në bazë të dispozitave të sipër përmendura të Kontratës Kolektive ,në fuqi nga data 18.04.2017.

Gjykata ka vlerësuar edhe thënjet e përfaqësuesit të të padituës kur ka theksuar, se me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit,mbi Arsimin Para Universitar,Ligjit të Arsimit të Komunave të Republikës së Kosovës nuk është paraparë kompenzimi i pagave jubilare dhe përcjellse,mirëpo kjo gjykatë konsideron se kontratat e nënshkruara në mes të palëve kanë bazën ligjore në Ligjin për Mardhënjet e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e qështjes së kontratës,kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Gjykata ka analizuar edhe thënjet e përfaqësuesi të të padituës i cili ka theksuar se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive ,mirëpo kjo gjykatë konsideron se Kontrata kolektive e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,gjegjësishtë MASHT vlen për të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës,sepse Qeveria e Republikës së Kosovës është organ i cili ka kompetenca për tërë teritorin e Kosovës,pra ushtrimi i kompetencave nga Qeveria e Kosovës nuk është i kufizuar vetëm në vendin ku ky organ e ka selinë në Prishtinë,e që ky përfundim ncjerret nga vetë emërtimi i këtij organi i cili quhet Qeveria Republikës së Kosovës,e jo Qeveria e ndonjë Komune të caktuar.:Përveq kësaj me neni 21 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës është paraparë se Autoritetet e larta të administratës shtetërore Qeveria në tërësi, Kryeministri, Zëvendës Kryeministrat dhe ministrat janë autoritetet e larta të administratës shtetërore.Ata udhëheqin dhe mbikëqyrin administratën shtetërore në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë.Kurse me nenin 22 të ligjit të sipër përmendur është paraparë se Organet e larta të administratës shtetërore ushtrojnë detyra tjera administrative në bazë të ligjit ose nëse ushtrimi i këtyre detyrave nga një organ i lartë i administratës shtetërore është më efikas dhe efektiv se delegimi i detyrave në një organ tjetër të administratës shtetërore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.